



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 1205/23 Datë: 15/09/2023

Në mbështetje të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), nenit 8 dhe 14 të Ligjit për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (GZ, Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ, Nr.20/12 qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë,(përditësuar me vendimin Ref.932/22), Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC), në mbledhjen e 115-të, të mbajtur më 25.08.2023, mori:

V E N D I M

1. Rikreditoen programet e studimit të Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2023 – 30 shtator 2026):
 1. *E Drejta Kushtetuese Administrative, LLM 60 ECTS, R; me kuotën maksimumi 35 studentë për vit akademik;*
2. Numri i studentëve zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
3. Obligohet Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” që deri më datë 15.11.2023 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit.
4. Obligohet Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” të raportoj dhe arsyetoj çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Lista e përditësuar e bartësve aprovet nga KSHC.
5. AKA rezervon të drejtën e aplikimit të dispozitave të nenit 21 të Udhëzimit Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, kurdo që vlerëson të arsyeshme dhe të nevojshme.
6. Institucioni i Arsimit të Lartë si në pikën I, mbanë përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkallim të këtij vendimi.
7. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim, për riakreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>E Drejta Kushtetuese Administrative, LLM 60 ECTS, R</i>	<i>Visar Morina</i>

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina".

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtarë) ka hartuar raportet e vlerësimit për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

1. Për programin e studimit; *E Drejta Kushtetuese Administrative, LLM 60 ECTS, R*, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Bertel De Groote dhe Horia Serban Onita, është organizuar me 18.05.2023, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht katër (4), Substancialisht dy (2) dhe Pjesërisht një (1) standarde.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 115-të, të mbajtur më datë 25.08.2023, ka shqyrtuar dokumentacionin e Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala mund të parashtrroj ankesë sipas Ligjit Nr.05/L-031 mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative në organin që ka nxjerrë këtë vendim, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar. Inicimi i konfliktit administrativ apo çfarëdo procedure tjetër administrative nuk e pengon ekzekutimin e këtij vendimi.*

Vendimi i dërgohet:

- Fakultetit Juridik i Universitetit të Prishtinës;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Asoc. Dr. Hasnija Dazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë